



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORATI

Nr. 169 Prot

Gjirokastrë, më 31.01. 2025

MIRATOI
REKTORI
Prof. dr. Jahō CANA



Lënda: Hapen thirrjet për shkrimin e projekteve propozimesh MSCA COFUND 2025 (Marie Skłodowska-Curie Actions) në kuadër të programit "Horizon Europe".

Në kuadër të Programit Horizon Europe, janë hapur thirrje të reja për projekt propozime, si më poshtë vijon:

Nr	Thirrja	Afati i fundit i dorëzimit të projekt propozimit
1	MSCA COFUND 2025	24 qershor 2025

Kjo thirrje për projekt propozime synon mbështetjen e aplikantëve të paraqesin propozime për programe të reja ose ekzistuese, doktorature ose postdoktorature me ndikim në rritjen e burimeve njerëzore në nivel rajonal, kombëtar ose ndërkombëtar. Këto programe do të bashkë-financohen nga MSCA COFUND (Marie Skłodowska-Curie Actions).

Programet e propozuara do të jenë të tipit "bottom-up", që do të thotë se mund të mbulojnë çdo disiplinë kërkimore, duke i krijuar institucionit aplikues hapësirë dhe fleksibilitet në zgjedhjen e temës për studim.

Projektet e propozura dhe financura për këtë thirrje, pritet të kenë rezultatet e mëposhtme:

- Për kandidatët si kërkues shkencor në procesin e doktoraurës ose postdoktoraturës ky program pritet të ndikojë në :
 - Thellimin e aftësive dhe kompetencave kërkimore shkencore dhe paisjen me aftësi të reja.
 - Përmirsimin e perspektivave të karrierës në jetën akademike dhe më gjerë.
 - Krijimin e një qasje të re rreth punësimit përmes përvojës ndërkombëtare dhe ndërdisiplinore.
 - Rritjen e kapaciteteve të rrjeteve dhe komunikimit me kolegët dhe kërkues të tjerë shkencorë, si dhe me publikun e gjerë që do të rrisë dhe zgjerojë ndikimin e kërkimit dhe inovacionit.

- Për institucionet pjesëmarrëse në projekt ky program pritet të ndikojë në:
 - Rritjen e cilësisë dhe qëndrueshmërisë së trajnimeve për kërkimin shkencor.
 - Rritjen e dukshmërisë dhe reputacionit të institucioneve pjesëmarrëse.
 - Rritjen e kontributit të institucioneve pjesëmarrëse në ekosistemet socio-ekonomike lokale, rajonale dhe/ose kombëtare;
 - Efekte pozitive të rezultateve të kërkimit shkencor në mësimdhënie dhe edukim në institucionet pjesëmarrëse.

Thirrjet, manualin e aplikimit dhe afatet e dorëzimit mund t'i gjeni në portalin e EU Funding & Tenders Portal: (<https://ec.europa.eu/info/funding-tenders/opportunities/portal/screen/opportunities/topic-details/HORIZON-MSCA-2025-COFUND-01-01?isExactMatch=true&status=31094501,31094502&frameworkProgramme=43108390&callIdentifier=HORIZON-MSCA-2025-COFUND-01&order=DESC&pageNumber=1&pageSize=50&sortBy=startDate>)

Gjithashtu, mund të kontaktoni me Sektorin e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Kërkimit Shkencor për informacion më të detajuar.

Zv. Rektore për Marrëdhëniet me Jashtë dhe Kërkimin Shkencor

Prof.asoc. Merita Isaraj